VENDIM
Nr. 37, datë 27.2.2020

MBI VENDIMIN E ERE NR. 10, DATË 20.1.2020, "MBI KËRKESËN PËR MOSLICENCIMIN E SHOQËRISË MP-HEC SHPK NGA ERE DHE KËRKESËN PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË ERE-s NR. 187, DATË 25.11.2019, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "MP-HEC" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "NIÇË"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 98, 107, 113, 117 dhe 144 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 16, pika 2, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.2.2020, pasi shqyrtoi relacionin nr. 36/3 prot., datë 25.2.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtorisë së Çështjeve Ligjore të ERE-s, "Mbi vendimin e ERE-s nr. 10, datë 20.1.2020, mbi kërkesën për moslicencimin e shoqërisë MP-HEC sh.p.k. nga ERE dhe kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Niçë",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 20.1.2020, pasi ka shqyrtuar relacionin e përgatitur në lidhje me kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Niçë", ka marrë vendimin nr. 10, datë 20.1.2020.

- Për marrjen e këtij vendimi të ndërmjetëm, ERE mori shkas nga shkresa e kërkuesit, e protokolluar në ERE, me nr. 782/3, datë 19.12.2019, i cili në cilësinë e palës së interesuar, ka kërkuar rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Niçë".

- Për shkak të kompleksitetit të çështjes në shqyrtim, nevojës për verifikime, të cilat konsistonin në përpunimin e të dhënave dhe korrespodencën/komunikimin me institucionet të tjera, për shkak të kompetencës së ligjit, me vendimin nr. 10, datë 20.01.2020, u vendos zgjatja e afatit të shqyrtimit të kërkesës së kërkuesit, me qëllim marrjen e një vendimi përfundimtar të mbështetur në prova, të verifikuara dhe konfirmuara nga organet kompetente.

- Ashtu sikurse konstatohet edhe në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 10, datë 20.1.2020, kërkesa e kërkuesit është paraqitur brenda afatit ligjor, në zbatim të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Kërkuesi, në raport me ERE-n, është në cilësinë e palës së interesuar në kuptim të dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative, në kushtet kur një vendimmarrje e ERE-s mund ta cenojë interesin e tij të ligjshëm dhe jo si një i licencuar apo përfaqësues i një organi drejtues i një subjekti të licencuar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE njoftoi zyrtarisht palët e interesit në lidhje me këtë vendim të ndërmjetëm, si dhe iu drejtua organeve kompetente për verifikimin e pretendimeve dhe të provave të depozituara nga kërkuesi dhe të atyre që ERE dispononte, në kuadër të një kërkesë për licencim.

- Në vijim, në ERE ka mbërritur kërkesa e shoqërisë MP-HEC sh.p.k. me nr. 369/1 prot. i ERE-s, datë 6.2.2020, me anë të së cilës shoqëria kërkon konstatimin e pavlefshmërisë absolute të

vendimit të Bordit të ERE-s nr. 10, datë 20.1.2020, si akt i marrë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 16, pika 5, të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Vendimi nr. 10, datë 20.1.2020, për shtyrjen e afatit, është një akt procedural, siç përcaktohet në pikën 3, të nenit 130, të Kodit të Procedurës Administrative dhe nuk mund të ankimohet veçmas nga vendimi përfundimtar.

- Konstatohet se në zbatim të nenit 116 i Kodit të Procedurës Administrative nuk ndodhemi në kushtet e aktit absolutisht të pavlefshëm (vendimi nr. 10, datë 20.1.2020), sepse për marrjen e këtij vendimi është ndjekur me përpikëri procedura e përcaktuar në nenin e sipërcituar, sa i përket kompetencës së ERE-s për të marrë këtë vendim, formës ose elementeve të tjera të detyrueshme të aktit administrativ.

- Gjithashtu, me shkresën nr. 369/1 prot. të ERE-s, datë 6.2.2020, shoqëria MP-HEC sh.p.k. ka njoftuar ERE-n për ndryshimin e administratorit të saj.

- Ndodhur në rrethanat kur vendimi i ndërmjetëm i Bordit të ERE-s nr. 10, datë 20.1.2020, lidhej me verifikimin e të dhënave që lidheshin me administratorin e shoqërisë MP-HEC sh.p.k., me ndryshimin e administratorit të shoqërisë, konstatohet se ky shkak ligjor ka rënë.

- Në këto kushte, ERE, në zbatim të nenit 68, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, organi që ka nxjerrë vendimin e ndërmjetëm ka të drejtën të shfuqizojë vendimin e ndërmjetëm.

- Me shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm të Bordit të ERE-s nr. 10, datë 20.1.2020, i marrë në rrethanat kur nga ERE u gjykua e nevojshme marrja e këtij vendimi për konstatimin e vërtetësisë dhe të legjitimitetit të pretendimeve të palës kërkuese për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, bie dhe shkaku ligjor për të cilin u mor ky vendim.

- Me konstatimin e rrethanave të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s nr. 10, datë 20.1.2020, në kushtet e nenit 130 të Kodit të Procedurës Administrative, si dhe konstatimin se nuk plotësohet asnjë nga rrethanat për shpalljen e pavlefshmërisë absolute të këtij vendimi, kërkesa e shoqërisë MP-HEC sh.p.k. adresohet në këtë vendimmarrje.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit të ERE-s nr. 10 /2020, "Mbi kërkesën për moslicencimin e shoqërisë MP-HEC sh.p.k. nga ERE dhe kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë 'MP-HEC' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Niçë'".

2. Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187/2019, për licencimin e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Niçë".

3. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë MP-HEC sh.p.k. për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 10/2020, "Mbi kërkesën për moslicencimin e shoqërisë MP-HEC sh.p.k. nga ERE dhe kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, për licencimin e shoqërisë 'MP-HEC' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Niçë'".

4. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti